



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 83

2 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

Faqe

VENDIME TË GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Vendim i GJEDNJ

Ankimi nr. 16114/10 "Petrit Sulejmani kundër Shqipërisë"...

3

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I KATËRT

VENDIM

ANKIMI NR. 16114/10
PETRIT SULEJMANI
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), duke gjykuar më 19 qershor 2012, si dhomë e përbërë nga:

Lech Garlicki, President

David Thór Björgvinsson

Päivi Hirvelä

Ledi Bianku

Zdravka Kalaydjieva

Nebojša Vučinić

Vincent A. De Gaetano, gjykatës,

dhe Lawrence Early, regjistruer i seksionit,

duke marrë në konsideratë ankimin e mësipërm të depozituar më 16 janar 2010,

duke marrë parasysh vërejtjet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe vërejtjet në përgjigje të paraqitura nga ankuesi,

pas shqyrtimit të çështjes, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Ankuesi, z. Petrit Sulejmani, është një shtetas shqiptar, i cili ka lindur dhe aktualisht vuan një dënim me burgim në Lushnjë, Shqipëri. Ai u përfaqësua para Gjykatës nga Z. I. Thiée, avokat që ushtron profesionin e tij në Bon, Gjermani.

2. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga përfaqësuesja ligjore (agjentja) e tyre e asaj kohe, znj. E. Hajro dhe më pas nga znj. L. Mandia nga Zyra e Avokaturës së Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

3. Faktet e çështjes që paraqiten nga palët mund të përmbliidhen si më poshtë.

1. Dënimi në mungesë i ankuesit

4. Më 31 tetor 2005 Gjykata e Rrethit Fier (gjykata e rrethit) dënoi ankuesin në mungesë për vepra penale të rënda në lidhje me shfrytëzimin e prostitucionit (neni 114/a § 4 të Kodit Penal). Ai u dënua me dhjetë vjet burgim dhe gjobë. Ai u përfaqësua nga një avokat (Z.) të caktuar nga familjarët e tij.

5. Më 4 prill 2006 dhe 19 shtator 2007, pas apelit të z., dënimi i ankuesit u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë (gjykata e apelit) dhe më vonë nga Gjykata e Lartë.

6. Më 23 tetor 2007 ankuesi u arrestua në Këln nga policia gjermane në bazë të një urdhri arresti shqiptar. Më 21 nëntor 2007 autoritetet shqiptare kërkuan ekstradimin e tij.

7. Gjatë procedurave të ekstradimit, Gjykata e Apelit e Këlnit i kërkoi autoriteteve shqiptare të jepnin një garanci se ankuesi do të rigjykohej nëse do të zhvillohej ekstradimi.

8. Më 25 janar 2008 Ministri shqiptar i Drejtësisë (Ministri) informoi autoritetet gjermane se ankuesi mund të depozitonte një kërkesë për rivendosje në afat. Pjesët përkatëse të shkresës së Ministrisë kanë tekstin e mëposhtëm:



“Duke iu referuar kërkesës së bërë në lidhje me një të drejtë për rigjykim në emër të Petrit Sulejmani për shkak të gjykimit të tij në mungesë, me anë të kësaj shkrese ju informoj se personi në fjalë mund të ushtrojë efektivisht të drejtën e tij për rivendosje në afat, në pajtim me nenin 147 § 3 të Kodit të Procedurës Penale brenda dhjetë ditësh nga dorëzimi i tij në Shqipëri.”

9. Mbi bazën e kësaj garancie, ankuesi u dorëzua pranë autoriteteve shqiptare më 17 mars 2008.

2. Kërkesa e ankuesit për rivendosje në afat

10. Më 24 mars 2008 ankuesi paraqiti një kërkesë për rivendosje në afat kundër dënimit të tij. Më 22 prill 2008 gjykata e rrethit rrëzoi kërkesën për shkak se vendimi i dënimit të tij në mungesë kishte marrë formë të prerë dhe kishte marrë fuqinë e *res judicata*. Ajo konstatoi se ankuesi kishte ushtuar efektivisht të drejtën e tij për apel, meqë përfaqësuesi i tij i caktuar nga familjarët e ankuesit kishte apeluar kundër vendimit të datës 31 tetor 2005.

11. Më 11 nëntor 2008, 19 janar dhe 8 tetor 2009 apeli i ankuesit u rrëzua përkatësisht nga gjykata e apelit, nga Gjykata e Lartë dhe nga Gjykata Kushtetuese

B. Ligji dhe praktika e brendshme përkatëse

1. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

12. Dispozitat përkatëse të KPP në lidhje me një kërkesë për rivendosje në afat janë si më poshtë:

Neni 48- Avokati mbrojtës i caktuar nga i pandehuri

“1. I pandehuri ka të drejtë të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës.

2. Zgjedhja bëhet me deklaram të bërë para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomandë.

3. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2.”

Neni 147-Rivendosja në afat

“1. Prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë patur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore.

2. Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore [në lidhje me paragrafin 1] dhe në lidhje me paragrafin 2 [brenda dhjetë ditëve] nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin. (...)

.....

5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin mbi themelin e çështjes.

6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit”.

Neni 410- Ankimi i të pandehurit

“....

2. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji.

...”

2. Praktika e gjykatave të brendshme në lidhje me procedimet në mungesë

13. Në vendimin e tyre unifikues nr. 2 të datës 14 tetor 2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosën se duke marrë parasysh karakterin e saj rreptësisht personal, një kërkesë për rivendosje në afat duhet të depozitohet vetëm nga i pandehuri ose avokati i caktuar prej tij, brenda dhjetë ditësh nga data në të cilën i pandehuri është informuar efektivisht për vendimin e dhënë në mungesë të tij. Kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet nga familjarët e të pandehurit, nëse i pandehuri nuk ishte efektivisht në dijeni të vendimit në mungesë. Kërkesa për rivendosje në afat duhet të shqyrtohet nga gjykata e rrethit e mbledhur me trup gjykues prej tre gjyqtarësh. Vendimi i Gjykatës së Rrethit mund të apelohej në Gjykatën e Apelit dhe më pas në Gjykatën e Lartë.

14. Në përgjigje të një kërkesë referuese nga Gjykata e Lartë për kushtetutshmërinë e neneve 48 § 3 dhe 410 § 2 të KPP, me anë të vendimit nr. 30 të datës 17 qershor 2010, Gjykata Kushtetuese vendosi se caktimi i një avokati ose mbrojtësi nga një familjar duhet të pranohet nga gjykatat e brendshme në masën që mund të vendosej se kjo përbënte shfaqje të hapur të synimit të të pandehurit për të mos marrë pjesë në procedime. I njëjti arsyetim u përdor për një kërkesë për rivendosje në afat të bërë nga mbrojtësi i caktuar nga familja e të pandehurit. Autoritetet duhet të përcaktojnë se i pandehuri nuk kishte efektivisht dijeni për dënimin e tij në mungesë dhe nëse i pandehuri kishte efektivisht dijeni mbi caktimin e mbrojtësit nga familja e tij.

ANKIMI

15. Ankuesi u ankua rreth gjykimit të tij në mungesë sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës.

LIGJI

16. Ankuesi u ankua se kishte patur një shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës si rezultat i gjykimit të tij në mungesë. Nenet 6 §§ 1 dhe 3 i Konventës parashikojnë si më poshtë:

“Në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtën e një gjykimi ... të drejtë ... nga [një] ... gjykatë ...”

3. Çdo person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet menjëherë në një gjuhë që kupton dhe në detaje, mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij ose t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet”.

e) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën e përdorur në gjykatë.”

17. Qeveria deklaroi se ankuesi u vu në dijeni për procedimet penale kundër tij dhe se ai i ishte fshehur qëllimisht drejtësisë. Ata paraqitën një prokurë të noterizuar të datës 2 tetor 2004 të nënshkruar nga ankuesi në të cilën ai kishte deklaruar se ishte në dijeni të procedimit penal të lënë pezull kundër tij. Pjesët përkatëse të prokurës kanë tekstin e mëposhtëm:

“Jam akuzuar për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit nga prokuroria e Korçës në bazë të një kallëzimi policor të depozituar nga (...).



Me anë të kësaj prokure, caktoj B. dhe J si avokatët e mi mbrojtës. Ata kanë të drejtë të më përfaqësojnë dhe të më mbrojnë para policisë, prokurorisë, gjykatës së shkallës së parë, Gjykatës së apelit, Gjykatës së Lartë dhe përpara instancave të tjera të procedimeve (...). Ata kanë të drejtë të marrin pjesë aktivisht në të gjitha procedimet, masat hetimore dhe seancat gjyqësore të zhvilluara kundër meje.

(.....)”

Qeveria u mbështet më tej në një letër që avokatët B. dhe J. i kishin dërguar prokurorisë së Korçës në emër të ankuesit.

18. Ankuesi nuk iu përgjigj këtij parashtrimi të Qeverisë ose ndryshe të jepte më shumë informacione në ankimin e tij.

19. Një deklaratë e parimeve të përgjithshme në lidhje me gjykimet në mungesë mund të gjendet në vendimin e Gjykatës në çështjen Sejdivic kundër Italisë [GC], nr. 56581/00, §§ 81-95, GJEDNJ 2006-II.

20. Gjykata vëren se nuk është diskutuar ndërmjet palëve që ankuesi nuk ka marrë njoftim zyrtar rreth zhvillimit të procedimeve të brendshme të gjykatave. Në fakt, njoftimet u nënshkruan nga anëtarët e familjes ankuese, e cila kishte caktuar edhe një avokat për ta përfaqësuar atë në mungesë përpara gjykatave të brendshme. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatojë nëse ankuesi ishte mjaftueshëm në dijeni të ndjekjes së tij penale dhe gjykimet, me qëllim përcaktimin nëse ai kishte hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur në gjykatë.

21. Vendimtare në këtë aspekt është nëse faktet e çështjes tregojnë qartë se ankuesi ishte mjaftueshëm i ndërgjegjshëm për mundësinë për të ushtruar këto të drejta në kontekstin e procedimeve specifike të filluara kundër tij dhe nëse ai mund të konsiderohet të ketë hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur në gjykatë. Në mungesë të një dijenie të tillë, kjo e drejtë gjithashtu nuk mund të konsiderohet të jetë hequr dorë në mënyrë të qartë, as të ushtrohet efektivisht (shihni, ndër të tjera, Stoyanov kundër Bullgarisë, nr. 39206/07, § 32, 31 janar 2012).

22. Në çështjen në fjalë, Qeveria paraqiti një kopje të vërtetuar të një prokure, me anë të të cilës ankuesi pranoi fillimin e procedimit kundër tij dhe caktoi avokatët B. dhe J. për të përfaqësuar atë. Ankuesi nuk e kundërshtoi autenticitetin e këtij dokumenti ose në fakt, nuk iu përgjigj parashtrimit të Qeverisë në vërejtjet e tij. Fakti se avokatët B. dhe J. u zëvendësuan më vonë nga avokatët e caktuar nga familjarët e tij nuk ndryshon rezultatin e qartë se ai ishte në dijeni më 2 tetor 2004 rreth procedimeve penale kundër tij. Duke zgjedhur të largohej nga vendi, ankuesi duhet të konsiderohet të ketë hequr dorë qëllimisht dhe në mënyrë të qartë nga të drejtat e tij sipas nenit 6 të Konventës dhe mund të kishte parashikuar pasojat e sjelljes së tij (shihni Jones kundër Mbretërisë së Bashkuar (dhjet.) nr. 30900/02 të datës 9 shtator 2003).

23. Rrjedhimisht, Gjykata nxjerr përfundimin se ky ankim duhet të rrëzohet si haptazi i pabazuar, në pajtim me nenin 35§§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata në mënyrë unanime
Shpall ankimin të papranueshëm

Lech Garlicki
President

Lawrence Early
Regjistrues

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 2.8.2012
Doli nga shtypi më 2.8.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 12 lekë